

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gënjeshtra e rezorteve elitare
ADRESA	https://lapsi.al/blendi-kajsiu-genjeshttra-e-rezorteve-elitare-i1093937
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:00:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 11:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c458efe890787f26acf1d758c934153eda4d85bfadcc2c14212aa3e1d73b6925
TEKSTI	a195953f9d7e23bc28100a7ce140c5a2fc8222fc90dd60dc6716fe843e72f766
PAMJA	fd61cccd2cb7a0ec558b0a82f88f855e6f57dde166cc16103673d7af4d6f5170

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	554aa728377e6070f00ba20ba8c0bcff190e4e19e78d5c456ba5ae4443edbe6e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e203f033d074a2d3c42a790e4ddfadf0e6c8e1c0300d49c3347be227adaa7f43
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/554aa728377e6070f00ba20ba8c0bcff190e4e19e78d5c456ba5ae4443edbe6e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gënjeshtër e rezortëve elitare

Në Sazan edhe në Zvërnec qeveria po financon komplekse luksoze banimi që do pasurojnë ndërtues lokal dhe ndërkombëtarë, herë duke i hequr taksat, herë duke i çuar infrastrukturë dhe herë duke privatizuar tokën dhe plazhet publike



BLENDI KAJSU • 17 SEPTEMBER 2026

Prej kohësh tashmë qeveria Rama ka deklaruar se motori i zhvillimit turistik dhe ekonomik të Shqipërisë duhet të jetë turizmi elitë. Shqipëria, deklaroi z. Rama, ka nevojë për turizmin elitë si shkretëtira për ujë.

Esenca e turizmit luksoz janë rezortet dhe hotelet elitare që tërheqin turistët e pasur, ndaj ato stimulohen dhe mbështeten nga qeveria me politika si "investitori strategjik" që u eliminon taksa ose u dhuron tokë publike.

Natyrisht që është shumë e debatueshme nëse motori i zhvillimit ekonomik të Shqipërisë mund dhe duhet të jetë turizmi elitë. Është akoma më e diskutueshme impakti që kanë rezortet elitare në punësimin dhe stimulimin e ekonomisë vendase po të kemi parasysh se një pjesë e mirë e të punësuarve dhe produkteve që ato konsumojnë vijnë nga jashtë.

Por nuk është kjo gënjeshtër themelore kur bëhet fjalë për rezortet turistike elitare në Shqipëri. Mashtrimi qëndron në faktin që qeveria Shqiptare prezanton si rezortë turistike elitare projekte ndërtimore rezidenciale. Kështu ndërtimi i komplekseve luksoze të banimit në bregdet shitet si zhvillim i industrisë elitare të turizmit.

Lexo më tej



13 SHTATOR, 16:52

TV francez "C News": Shqiptarët po i bëjnë gjyqin modelit politik Rama

Shembulli më i fundit është projekti në Zvërnec dhe Sazan që kryeministri ia ka servirur publikut shqiptar si një investim që do prodhojë një rezort elitë që do tërheqë markat më elitare të hotelerisë në botë. Kështu krijohet përshtypja që kemi të bëjmë thjesht me një investim në biznesin e hotelerisë elitare.

Kjo është një çerek e vërtetë që fsheh faktin se investime të tilla në thelb janë ndërtime rezidenciale që do prodhojnë vila dhe apartamente që do u shiten personave privatë me nivel të lartë të ardhurash. Kështu biznesi i ndërtimit të komplekseve luksoze të banimit servitë si industri e hotelerisë elitare.

E thënë ndryshe ndërtimi kryesor që u projektua në Sazan nuk është një rezort apo hotel luksi por një kompleks banimi me apartamente dhe vila luksoze private që do blihen nga milionerët. Ky ishte koncepti që u prezantua në emisionin Opinion të Blendi Fevziut nga Asher Abhesera partneri i Jared Kushner në këtë projekt. (**shiko ktu**)

Ndaj për të kuptuar atë që po projektohet në Sazan dhe Zvërnec mjafton të shikosh "rezortin elitë" Green Coast që është ndërtuar në Palasë. Edhe Green Coast paraqitet si rezort ndonëse në fakt është një qytet (ose lagje) ndërtuar buzë detit për shtresat më të pasura shqiptare dhe ndërkombëtare.

ide



Gënjeshtër e rezortëve elitare
Blendi Kajsu



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Andi Bushati

MOTITIRANA

29°C

KËMBIMIEURO

91.65

aktuale

08:06

Seancë brenda, protestë jashtë/ Qytetarët zhvendosen para Kuvendit

08:02



Seancë maratonë në Kuvend/ Pesë interpelanca në rend dite, sot vendoset edhe për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



Foto 1. Greencoast Palasë



Sikurse e tregon qartë foto nuk kemi të bëjmë me një rezort por me një kompleks privat banimi që shet vila dhe apartamente private për persona privatë. Mjafton të hysh në internet dhe të kesh katër apo pesëqind mijë euro për të blerë një apartament 1+1 apo miliona për një nga vilat e kompleksit të banimit. **(shiko ktu)**

Natyrisht që tek kompleksi i mësipërm ka edhe një hotel luksoz me pesë yje që quhet Green Coast Hotel. Ama ky hotel është thjesht një pjesë e vogël e megaprojektit që në thelbin e tij është ndërtimi i një kompleksi rezidencial banimi. Pra bëhet fjalë për një biznes ndërtimor dhe jo për një biznes turistik.

Ndërtime të tilla fshihen pas formulës së “rezortit elitare” jo vetëm sepse kështu janë më të përtypshme për publikun por edhe sepse përfitojnë ndihmë dhe mbështetje financiare nga qeveria. Ligji i investitorit strategjik është për biznesin e turizmit dhe jo për atë të ndërtimit.

Imagjinoni sikur qeveria Rama ti thoshte qytetarëve shqiptar se do i heqim taksat për dhjetë vjet dhe do ti ofrojmë truall publik një ndërtuesi që do ndërtojë kompleks banimi luksoz për milionerët. Është njësoj sikur qeveria të mbështeste ndërtimin e vilave private tek Rolling Hills apo tek Gjiri i Lalëzit duke i emërtuar ato rezorte elitare dhe jo komplekse banimi.

Kjo është në fakt ajo që po ndodh si në Sazan edhe në Zvërnec. Qeveria po financon komplekse luksoze banimi që do pasurojnë ndërtues lokal dhe ndërkombëtar, herë duke i hequr taksat, herë duke i çuar infrastrukturë dhe herë duke privatizuar tokën dhe plazhet publike.

Për të justifikuar këtë devijim të pasurisë publike tek xhepat e miliardërve lokal dhe ndërkombëtarë kryeministri flet vazhdimisht për rezorte dhe hotele luksoze, për arkitektë me famë botërore dhe injoron tërësisht faktin se si në Zvërnec edhe në Sazan janë projektuar komplekse banimi ku me qindra e mijëra apartamente dhe vila që do u shiten personave privat, si në çdo projekt tjetër ndërtimor.

Projektet që u prezantuan fillimisht për Zvërnecin dhe Sazanin tregonin qartë pikërisht këtë fakt. Aty shfaqeshin me mijëra apartamente dhe vila me vendparkim jahtesh dhe marina private.

Foto 2. Imazhi i projektit në Zvërnec i shpërndarë nga Jared Kushner



Nga torturat te vrasja e 96 personave/ Pse i dënoi Haga katër ish-krerët e UÇK-së



"Marre", Ramën e bëjnë copë në rrjetet sociale pas dënimit të Hashim Thaçit



VIDEO/ Del nga SPAK arkitekti që projektoi vilën e Belinda Ballukut



Departamenti amerikan i Shtetit i vë kapakun, përshëndet dënimin e ish-krerëve të UÇK



Foto 2 është imazhi i projektit të Zvërnecit i bërë publik nga vetë Jared Kushner. Nuk bëhet fjalë për një rezort apo hotel luksi por për ndërtimin e disa komplekseve banimi që së bashku përbëjnë një qytet për milionerët.

Është një mega projekt ndërtimor që publikut shqiptar i shitet si “rezort elitar” sepse është e pajustificueshme tu thuash shqiptarëve se do i dhurojmë të vetmin ishull që kemi, apo perlën tonë natyrore lagunën e Nartës dhe Zvërnecin, një firme ndërtimi që të ndërtojë dhe shesë aty ca vila dhe apartamente luksoze.

Pikërisht për këtë arsye sapo filluan protestat kryeministri Rama insistonte se nuk ka projekt dhe mohoi vërtetësinë e imazheve që prej kohësh qarkullonin në internet, të publikuara nga vetë ideatorët e projektit.

Lexo më tej



6 QERSHOR, 16:55

Zbulohet dokumenti: Rama përgatit transferimin e ishullit të Sazanit te Jared Kushner

Paradoksi i mohimit të ekzistencës së një projekti që po vetë kryeministri insistonte se do realizohej buronte nga fakti se një vështrim sado i përciptë i projektit tregonte se rezorti dhe hoteli luksoz ishin element periferik në të. Thelbi i këtyre projekteve, si në Sazan edhe në Zvërnec, ishte ndërtimi i komplekseve luksoze banimi, shpesh në truall publik.

Ky ishte një fakt i papërtypshëm si për qytetarët edhe për socialistët shqiptarë. Ndaj kryeministri u detyrua të artikulonte absurditete llogjike të tipit “projekti që nuk ekziston do ndërtohet dhe nuk do dëmtojë ambientin, pavarësisht se nuk ka studim ambiental sepse nuk ka projekt”.

Absurditeti i mësipërm buron nga gënjeshtra e madhe me të cilën janë mbështjellë projekte si ai i Zvërnecit dhe i Sazanit, idea se bëhet fjalë për biznese turistike dhe jo për biznese ndërtimi.

E vërteta është se ajo që po gatuhet në Zvërnec dhe Sazan është e njëjtë me atë që u ndërtua në Greencoast, një mega projekt ndërtimi që betonizon natyrën dhe mbush xhepat e ndërtuesve pranë qeverisë. Ndaj emërtimi i projekteve të tilla si rezorte turistike elitare është një gënjeshtër e madhe.

Shkruar nga Blendi Kajsu enkas per lapsi.al

Të këshilluara



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

Deri më tani për ta nxjerë Lalin nga burgu u përdor alibia e mos dëmtimit të interesit të qytetarëve dhe punëve të Tiranës. Këtë e tutje, pasi mirë apo keq, Gjykata e Lartë vendosi të lërë edhe për një kohë relativisht të gjatë të izoluar, duhet të jesh i pafytyrë që të mbrosh idenë se ai mund të mbetet kryebashkiak edhe në dëm të këtij interesi



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit

Fabula e përdorimit të sipërmarrëses Arieta Puca, që u promovua nga Rama, për ti hapur rrugën hyrjes në skenë të mikut të tij hebre, përbën realizimin më gjenial të të njëjtit skenar të rilindjes: "Sa më e madhe ëndrra që hidhet në treg, aq më e rëndë është goditja financiare që po përgatitet"



Insistimi tek krimi, arsyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet



Fabula e re e Edi Ramës: Shqiptarëve pasqyrën, për vete milionat

Në sallat mortore të rilindjes, të gjithë e dinë se pallavrat e kryeministrit nuk mund ta ndryshojnë realitetin ku ata e kanë sjellë vendin. Asnjë pasqyrë nuk reflekton dot një Shqipëri tjetër nga ajo që ekziston në të vertetë.



Blendi Kajsiu: Skandali i vërtetë në rastin Veliaj

Që në momentin e marrjes si i pandehur një standarti politik minimal diktonte dorëheqjen e tij nga detyra në funksion të interesit të Tiranës dhe qytetarëve të saj



Po sikur Lali të dalë nga burgu?

Një pakt është përvijuar mes kryeministrit dhe kryebashkiakut të burgosur për të kthyer këtë të fundit në zyrë. Po cila do të qe konsequenca për një reformë në drejtësi, që pushtetarët e lartë ia shkëlyen dyert e qelive?





Një moment vendimtar për Shqipërinë



Ngatërresa e madhe me Ergys Agasin

Ato që tregojnë më pak për historinë e "Gysit" janë pamjet dhe deklaratat e nxjerra nga arkivat për lidhjen e tij me Ramën. Pasi nuk është i pari që njollos të dytin

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.